

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NË LEKË, PËRNDRYSHE SHKRUHET

TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK

Selia: Rr. Sami Frashëri, Pall. TID
Tirana – Albania

Pasqyrat Financiare per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2017

(me raportin e audituesit të pavaruar ne vazhdim)

Tirane, 29 Mars 2018



PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Përmbajtja

1. Opinioni i Audituesit të Pavarur
2. Bilanci Kontabël
3. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
4. Pasqyra e flukseve monetare
5. Pasqyra e ndryshimeve në kapital
6. Shënime



RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Ortakut të Shoqërisë
 "Tirana International Development" Shpk
 Kapitali i regjistruar ne QKB-ne prej 650.734 mije leke
 Rruga "Sami Frasheri", Pll. "TID"
 Tirane – Albania

Opinionit

Une kam audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare **"TID"** sh.p.k., (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur me datën 31 Dhjetor 2017, si edhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tim, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë tregtare **"TID"** sh.p.k., me datën 31 Dhjetor 2017, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombetare të Kontabilitetit (SKK).

Baza për Opinionin

Une e kreu auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë e mia sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Une jam e pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kam përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Une besoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Organeve të Qeverisjes për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Standardet Kombetare të Kontabilitetit (SKK), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Drejtimi ka gjithashtu, përgjegjësinë për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar veprimtaritë në vijimësi, duke dhënë për këtë qëllim, kur është rasti, informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë nisur nga parimi kontabël i vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likujdojë shoqërinë, të ndërpresë aktivitetet e saj, ose rasteve kur drejtimi nuk ka alternativë tjetër reale përveç likuidimit të shoqërisë.

Organet e ngarkuara me qeverisjen kanë përgjegjësinë për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona të auditimit janë: të arrijmë një siguri të arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi kanë ose jo anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport, i cili përfshin opinionin e audituesit. Siguria e arsyeshme megjithatë është një siguri e nivelit të lartë, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku pritet, që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një auditim i pasqyrave financiare në përputhje me SNA-të, kërkon që ne si auditues të ushtrojmë gjykimin profesional dhe të ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Une gjithashtu:

- Identifikoj dhe vlerësoj rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i anomalisë materiale si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara ose anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Siguroj një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë.
- Vlerësoj përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerr një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë dhe, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Kur arrij në përfundimin që ka një pasiguri une duhet të tërheq vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikoj opinionin tim. Konkluzionet e mia bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tim të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Une komunikoj me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që une mund të identifikoj gjatë auditimit.

Audituesi ligjor

Luciana LASKA, (AL/CPA)
Partner Auditimi
Rruga Sheh Zeneli, Lagjia Hajro Çakerri,
Pallati Nr.7777, Kati 1

27 Mars 2018



PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Bilanci Kontabël

	Më datën 31.12.2017		
	Shen	31.12.2017	31.12.2016
AKTIVET			
Aktivët Afatshkurtëra			
Aktive monetare	4	154,980,140	38,555,064
Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	5	543,884,713	612,311,327
Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme	6	11,286,986	1,433,595
Instrumente të tjera borxhi	7	2,077,500	2,077,500
Totali		557,249,199	615,822,422
Inventari			
Lëndët e para	8	3,779,358	2,945,420
Produkte të gatshme	8	138,583,760	141,897,228
Mallra për rishitje	8	8,451,059	10,428,718
Parapagesat për furnizime	8	-	-
Inventar i imet	8	7,351,683	5,134,128
Totali		158,165,860	160,405,494
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	9	7,187,482	274,301
Total i Aktiveve Afatshkurtra (I)		877,582,681	815,057,281
Aktivët afatgjatë			
Investimet financiare afatgjatë			
Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara		-	-
Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje	10.a	403,727,302	11,505,000
Aksione dhe letra të tjera me vlerë		-	0
Llogari/Kredi të dhena afatgjatë	10	81,054,812	389,927,932
Totali		484,782,114	401,432,932
Aktive afatgjatë materiale			
Toka	11	-	0
Ndërtesa	11	2,999,190,812	3,161,118,766
Makineri dhe pajisje	11	53,003,208	48,229,545
Aktive të tjera afatgjatë materiale (me vl.kontab.)	11	13,756,325	15,743,204
Aktive afatgjatë materiale në poces	11	-	0
Totali		3,065,950,346	3,225,091,516
Totali i aktiveve Afatgjatë (II)		3,550,732,460	3,626,524,448
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		4,428,315,141	4,441,581,729
DETYRIMET DHE KAPITALI			
DETYRIMET Afatshkurtëra			
Huat dhe parapagimet			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	12.1	343,233,939	735,967,636
Të pagueshme ndaj punonjësve	12.1	3,936,224	3,725,453
Detyrime tatimore	12.1	4,918,648	5,763,337
Hua të tjera	12.1	0	24,000
Parapagimet e arkëtuara	12.1	21,759,647	21,963,515
Totali i detyr. afatshkurtra		373,848,458	767,443,941
DETYRIME AFATGJATA			
Huat afatgjatë			
Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare	12.2	2,163,364,783	1,792,667,761
Huamarrje të tjera afatgjatë	12	605,452,973	548,848,667
Totali		2,768,817,756	2,341,516,428
Provizionet afatgjatë		0	0
Totali i detyr. afatgjatë		0	0
Totali i detyrimeve		373,848,458	767,443,941
Kapitali	13		
Kapitali aksionar		650,734,000	650,734,000
Rezerva statusore		-	-
Rezerva ligjore		5,675,371	3,700,731
Fitimet e pashpërndara		676,211,989	638,693,824
Fitimi (humbja) e vitit financiar		-46,972,433	39,492,805
Totali i kapitalit (III)		1,285,648,927	1,332,621,360
TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT		4,428,315,141	4,441,581,729

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-24

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Për periudhën që përfundon më 31.12.2017

		Viti 2017	Viti 2016
Shitjet neto	14	512,344,533	1,472,679,363
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	15	48,015,795	3,231,773
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimit në proces		-	-
Materialet e konsumuara .	16	-144,959,381	-1,077,561,208
Kosto e punës	17	-	-
-Pagat e personelit	17	-58,209,415	-58,050,057
-Shpenzimet për sigurimet shoqerore dhe shendetësore	17	-9,675,799	-9,702,145
tjera personeli		-	-
Amortizimi dhe zhvleresimet	10, 18	-171,261,250	-102,912,274
Shpenzime të tjera	19	-60,097,625	-40,592,888
Totali i shpenzimeve		-444,203,470	-1,288,818,571
Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore		116,156,858	187,092,564
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare:			
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi	20	-125,806,157	-131,858,344
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	21	-3,949,093	-232,289
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare		-	-
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		-129,755,250	-132,090,633
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		-29,877,698	-
Fitimi (humbja) para tatimit	22	-43,476,090	55,001,932
Shpenzimet e tatimit aktual mbi fitimin	22	-3,496,343	-15,509,127
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		-46,972,433	39,492,805
Të Ardhura të Tjera gjithpërfshirëse			
Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAM		-	-
Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAFinanciare		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse neto nga tatimet			
Totali i të ardhurave neto gjithpërfshirëse për periudhën		-46,972,433	39,492,805

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-24

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e flukseve monetare- Metoda indirekte
Për periudhën që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

	Shen	2017	2016
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi pas tatimit	25	-46,972,433	39,492,805
<i>Rregullime për shpenzimet jomonetare:</i>			
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	171,261,250	102,912,274
		124,288,818	142,405,078
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:			
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	5,6,7	58,573,223	79,385,019
Rënie/(ritje) në inventarë	8	2,239,634	138,922,165
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	11	-392,733,697	194,388,115
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	12	210,771	142,507
Rritje/(rënie) në shpenzimet e shtyra	9	-6,913,182	136,424,696
Rritje/(rënie) në parapagimet e arketuara	15	-203,867	17,880,807
Rritje/(rënie) në detyrimet tatimore	13	-844,689	-1,553,687
Rritje/(rënie) në Hua dhe Obligacione Afatshkurtra	14	-24,000	-450,967
<u>MM Neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</u>		-215,406,989	707,543,733
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	10	-21,955,095	-3,439,594,892
Arkëtime nga shitja / nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale	10	9,835,014	2,752,536,497
Rritje kuote pjesëmarrje		-392,222,302	6,907,239
<u>MM neto, e përdorur në aktivitetet investuese</u>		-404,342,382	-680,151,156
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Hua banaker e të tjera		365,477,425	-303,851,856
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		370,697,022	202,519,291
<u>MM neto e përdorur në aktivitetet financiare</u>		736,174,447	-101,332,565
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		116,425,075	-73,939,988
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		38,555,064	112,495,051
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		154,980,140	38,555,064

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-24

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT" SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e ndryshimit të kapitaleve të veta për periudhën që mbyllet më 31 Dhjetor 2017
000/lek

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Fitimi i Pashpërndarë	Fitimi i periudhes	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	650,734,000	1,365,170	594,318,173	46,711,212	1,293,128,555
Emetim i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-
Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël	-	-	46,711,212	39,492,805	86,204,017
Dividente të Paguar	-	-	-	-	-
Rritje e Rezerves së Kapitalit	-	2,335,561	-2,335,561	-	-
Kalim në fitim të pashpërndarë				(46,711,212)	(46,711,212)
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	650,734,000	3,700,731	638,693,824	39,492,805	1,332,621,360
Emetim i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-
Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël	-	-	39,492,805	-46,972,433	-7,479,628
Dividente të Paguar	-	-	-	-	-
Rritje e Rezerves së Kapitalit	-	1,974,640	-1,974,640	-	-
Kalim në fitim të pashpërndarë				(39,492,805)	39,492,804.52
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	650,734,000	5,675,371	676,211,989	-46,972,433	1,285,648,927

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-24

Pasqyrat Financiare "Tirana International Development" Shpk janë aprovuar nga Drejtimi i Degës
Më datë 29 Mars 2018

Behar Male


Administrator i vetëm



TIRANA INTERNATIONAL
DEVELOPMENT
TIRANA
ALBANIA

Arta Halili

Shefe e Financës



PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHIPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria TID sh.p.k., në vijim e quajtur Shoqëria, është themeluar me vendimin e Gjykatës Tiranë nr.20374, në vitin 1998 në datën 3 të muajit Dhjetor, nga ortaku i vetëm, i cili ishte edhe administrator i shoqërisë, z. Behar Male. Gjatë viteve kapitali i shoqërisë ka ndryshuar dhe këto ndryshime janë formalizuar me vendimet përkatëse të gjykatës së Tiranës. Në datën 31 Dhjetor 2017 përberja dhe zotërimi i kapitalit të shoqërisë TID sh.p.k. është 650,734,000 lekë dhe paraqitet si vijon:

Emri i ortakut	Vlera e kapitalit	Numri i pjeseve	% e kapitalit
BEHAR MALE	650,734,000	100	100%
Totali	650,734,000	100	100%

Ortak i vetëm dhe Administrator i shoqërisë është Behar Male.

Objekti kryesor i shoqërisë është Import-eksport, rieksporim, tranzitim, tregetim të gjitha mallrave të ndryshëm me shumice e pakice, produkte me origjin buqësor, blektorale, mallra të ndryshëm ushqimor të gatshëm e gjysem të gatshëm, materiale ndertimi të llojeve të ndryshme, pajisje elektroshtepiake, hidrosanitare. Marrje persiper e hartimit të projekteve të ndryshme ndertimore të fushave të ndryshme dhe të realizimit të anes ndertimore të tyre. Investime në fushen e turizmit, infrastrukture, konvertim të valutave, qiradhenes se zyrove, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme Veprimtari në fushen e estetikës dhe dermokozmetikës, hapja dhe mbajtja e qendrave me profil estetikën, dermo-kozmetikën, trajtimin e lekures dhe trupit, masazheri dhe mirembajtje trupore, fitness dhe pishina. Gjate vitit 2014 shoqeria ka vazhduar me aktivitetin në ndertim, qiradhenie, veprimtari tregtare në fushen e shërbimeve të kujdesit ndaj shëndetit si qendra wellnes , qender sportive ,etj.

Adresa e Shoqërisë është : Rruga rruga Sami Frasheri, nr 56, shkalla F, kati I.

Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Degen e Tatimpaguesve të Medhenj me NIPT J82427007R.

Me 31 Dhjetor 2017 shoqëria ka 95 punonjës (31 Dhjetor 2016, 89 punonjës)

2. Parimet e përgatitjes së pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabël

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara të shpallura me urdhërin e Ministrit të Financave nr 64 dt 22.07.2014 Për shpalljen e detyrueshme të tyre.

(b) Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike.

Politikat kontabël për shifrat e vitit 2017 janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK dhe të ligjit nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe paraqiten në shënimin vijues.

3. Politikat kontabel kryesore

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur sa me poshte:

3.1 Aktivët Afatgjatë

AAGj janë njohur në momentin kur shoqëria është bërë titullare ligjore e tyre ose ka kontrollin ekonomik mbi to, pret të marrë përfitimet në të ardhmen dhe kur mund të vlerësohen në mënyrë të bësueshme. Në njohjen fillestare aktivet vlerësohen me koston e sigurimit të tyre e cila përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve.

Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundur që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative. Në bilanc paraqiten të vlerësuar me koston e amortizuar e cila rezulton si diferencë nga kostoja e tyre minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi i AAM të hyra gjatë vitit llogaritet në raport me kohën e hyrjes së tyre. Në rast rivlerësimi aktivet vlerësohen me koston e caktuar në raportin e ekspertit të vlerësimit. Amortizimi i AAM llogaritet në përputhje me normat e caktuara nga ligji nr. 8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat". Amortizimi i ndërtesave llogaritet me metodën lienare kurse amortizimi i grupeve të tjera llogaritet me metodën e vlerës së mbetur, duke marrë për afërsisht jetëgjatësinë e këtyre aktiveve. Metodatat dhe normat e amortizimit të përdorura nga shoqëria paraqiten si me poshte:

	Norma Amortizimit %	Metoda Llogaritjes
Ndërtesa	5%	me Vleften e mbetur
Makineri e pajisje	20	me Vleften e mbetur
Mjete Transporti	20	me Vleften e mbetur
Mobilje Orendi	20	me Vleften e mbetur
Pajisje Informatike	25	me Vleften e mbetur

3.2. Aktivët dhe detyrimet financiare

a) Aktivët financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme Huadhëniet dhe të Arkëtueshmet të cilat klasifikohen në Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesa të tjera. Manaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare.

Llogari e kërkesave të Arkëtueshme

Kërkesat e arkëtueshme ndaj klientave njihen si aktive atëherë kur Shoqëria bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për t'u arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i Shoqërisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur është evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumatat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa.

Llogari e kërkesave të Arkëtueshme -Vazhdim

Shuma e zhvlerësimit nga borxhi i keq është diferenca midis vlerës së mbartur të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të parashikuara të ardhshme të parave, të skontuar me normën origjinale efektive të interesit. Vlera e mbartur e aktivitetit zvogëlohet duke përdorur një llogari Zhvlerësime, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kur një Llogari e Arkëtueshme nuk mund të arkëtohet, ajo nuk paraqitet në shpenzime por çrregjistrohet nga Llogaria e Zhvlerësimit të borxhit të keq dhe nga Llogaria e kërkesave të Arkëtueshme. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë ç'rregjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma.

Një aktiv financiar ç'rregjistrohet pjesërisht ose totalisht (nuk paraqitet më në bilancin kontabël) në rastin kur Shoqëria parashikon që nuk do gjenerohen më flukse monetare nga ky aktiv dhe nuk ka më kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin.

Shoqëria paraqet në aktivet e saj të gjitha shpenzimet e parapaguara dhe të cilat pret që t'i shpërndajë në periudhat e ardhme, ose të drejtat për të ardhurat e llogaritura në avancë.

b) Detyrimet financiare

Shoqëria i klasifikon detyrimet financiare në kategoritë vijuese: Llogari të pagueshme dhe detyrime tregtare të tjera dhe detyrime financiare.

Detyrime tregtare dhe të tjera paraqesin Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar. Detyrimet ndaj shtetit janë paraqitur me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual që ka lindur nga një ngjarje e shkuar, shlyerja e të cilit pritet të shoqërohet me dalje të burimeve dhe mund të bëhet një vlerësim relativisht i sakte i shumës së detyrimit.

3.3 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë MM në dore dhe ato të mbajtura në banka.

Në përputhje me SKK 7 "Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare", Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshijnë MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak). Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshijnë investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollat e këmbimit, etj).

Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korrspondojnë me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

3.4 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme. Në hyrje inventarët e materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri. Në bilanc inventarët paraqiten me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme e cila është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus koston e parashikuar të shitjes. Shoqëria i ka vlerësuar inventarët gjendje në fund të vitit me kosto mesatare.

3.5 Njohja e te ardhurave

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimit e pronësisë së produktit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri. Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo. Të ardhurat nga ndërtimi njihen në masën e kryerjes së punimeve mujore të kryera dhe situacionuara. Të ardhura nga bari dhe restoranti regjistrohen kur arkëtohen mjete monetare ose kur realizohet shitja.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëhere kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

Shpenzime per personelin

(i) Kontributet per sigurime shoqerore dhe te ngjashme

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj normal, kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Koston përkatës të bërë në emër të Shoqërisë ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave me ndodhjen e tyre.

(ii) Leje e zakonshme e paguar

Shoqëria njeh si një shpenzim personeli ato kosto që lidhen me lejen e zakonshme atëhere kur është përdorur nga personeli përkatës.

3.6 Transaksionet me monedhat e huaja

Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

(a) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon shoqëria ("monedha funksionale"). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

(b) Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj date. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "të tjera të ardhura (shpenzime) financiare".

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRIMET

3.6 Transaksionet me monedhat e huaja-vazhdim

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2017 janë:

Data /	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Monedha		
Euro	132.95	135.23
USD	111.10	128.17

3.7 Rezultati tatimor

Shoqëria llogarit dhe njih vetëm tatimin aktual. Norma aktuale e tatimit mbi të ardhurat llogaritet bazuar në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël. Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korigjuar atë me shpenzimet e panjohura. Manaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon t'i paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

4. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e parave në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë si në tablenë më poshtë:

Pershkrimi	31 Dhjetor-17	31 Dhjetor-16
Mjete monetare në banke	69,399,670	13,693,658
Mjete monetare në arkë	85,580,470	24,861,406
Total	154,980,140	38,555,064

Konvertimi i gjendjes në valutë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2017 të shpallur nga Banka e Shqipërisë. Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në valutë të huaj janë sistemuar në rezultat. Shoqëria nuk ka ekuivalente të mjeteve monetare

4.1. Mjetet monetare në llogaritë bankare

Gjendja e llogarive bankare në fund të periudhës në kontabilitet përputhet me gjendjen sipas nxjerrjes së llogarive bankare. Përbërja analitike e llogarive bankare paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Vendosje Ne lek		
Llogari Rrjedhese prane Bankave	9,145,218	849,987
Depozita prane Bankave	-	-
Vendosje Ne Monedhe te huaj		
Llogari Rrjedhese prane Bankave	60,254,451	12,843,672
Depozita prane Bankave	-	-
Total	69,399,670	13,693,658

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUMET

4.2 Mjetet monetare në arkë

Gjendja në arkë në vitin 2017 përbëhet nga gjendjet e parave në monedhën kombëtare lek ,dhe në euro në fund të periudhës.

Pershkrimi		31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
	Vendosje Ne lek		
Arka ne lek		5,352,388	12,062,729
	Vendosje Ne Monedhe te huaj		
Arka ne euro		80,228,082	12,798,665
Total		85,580,470	24,861,394

5.Te drejta te arketueshme

Në kete post me date 31 Dhjetor 2017, paraqiten ne bilanc kërkesat ndaj të tretëve me vleren e tyre te arketueshme. Ato përbëhen tërësisht nga të drejtat ndaj klientave, furnitore, debitorë, shteti tatim taksa, instrumenta te tjera borxhi. Përbërja analitike e këtyre të drejtave paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Kliente lek	425,411,211	552,220,684
Kliente Euro	118,473,502	60,090,643
Total	543,884,713	612,311,327

6. Te drejta te tjera te arketueshme

Paraqitja e te drejta te tjera të arkëtueshme jepet në tabelën vijuese:

Pershkrimi	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Parapagime dhe pagesa pjesore	11,231,842	-
Shteti "Tatim Taksa", TVSH	-	1,414,919
Te tjera	55,145	18,676
Total	11,286,986	1,433,595

7. Instrumenta te tjera borxhi

Paraqitja e Instrumentave te tjera borxhi jepet ne tabelen e meposhtme:

Pershkrimi	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
INFINITY POOL S AL	2,077,500	2,077,500
Total	2,077,500	2,077,500

8. Inventaret

Gjendja e inventarëve materialeve te para analitikisht paraqiten si ne tabelen vijuese:

Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
Materiale dhe Lende te para	3,779,358	2,945,419
Te tjera gjendje inventari	7,351,683	5,134,128
Produkti i gatshem (ndertimi)	138,583,760	141,897,228
Mallra	8,451,059	10,428,718
Totali	158,165,860	160,405,494

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUE

9. Parapagimet dhe Shpenzimet e shtyra

Një paraqitje analitike e këtyre shpenzimeve jepet ne tabelen me poshte:

Shpenzime, kosto per tu shperndare	Viti 2017	Viti 2016
Kosto për tu shpërndarë	273,056	274,301
Parapagime	6,914,427	-
Totali	7,187,482	274,301

Kosto për tu shpërndarë paraqet shpenzime të shtyra për vitin e ardhshëm.

10. Aktivët financiarë afatgjatë

Përbërja e këtij zëri paraqitet si vijon:

Pershkrimi i Llogarive	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Investime ne pjesmarrje	403,727,302	11,505,000
Kerkesa te tjera te arketueshme afatgjata	81,054,812	389,927,932
Total	484,782,114	401,432,932

10.a) Investime në pjesmarrje

Paraqet një pjesmarrje në kapital në shoqëritë si me poshte :

Pjesmarrje te tjera në njësi të kontrolluara	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Pjesmarrje ne shoqerine Hydroborsh shpk	7,005,000	7,005,000
Pjesmarrje ne shoqerine The Plaza Tirana sha	396,722,302	4,500,000
Totali	403,727,302	11,505,000

Kërkesa të tjera të arkëtueshme afatgjatë paraqet huat e dhëna shoqërive të tjera.

11. Aktivët Afatgjatë

Gjatë vitit 2017 shtesat e AAM janë paraqitur me koston e tyre.

Në vijim paraqitet një pasqyrë në lidhje me lëvizjet e Aktiveve Afatgjatë dhe Amortizimit të tyre gjatë vitit 2017:

Pasqyra e ndryshimit të Amortizimit të AAM materiale

	Toka, Ndertime	Installme, makineri e pajisje	Mjete transporti	Te tjera ne shfrytezim (mohileri, pajisje, etj.)	Aktive afatgjata materiale ne proces	Total
Gjendja 31 Dhjetor 2015	766,823,808	189,065,663	12,375,664	38,795,980	2,009,001,643	3,016,062,757
Blerjet gjatë viti ushtrimor	2,710,612,039	250,874		2,871,582	725,860,397	3,439,594,892
Shitjet gjatë viti ushtrimor		-38,796,869	-2,079,104			-40,875,973
Nxjerrje jashte perdorimit		-9,831,370				-9,831,370
Plusvlere/minusvlere rivlerësimi						-
Pakësime/Shtesa të tjera		-13,025,728		-901,903	-2,734,862,039	-2,748,789,670
Gjendja 31 Dhjetor 2016	3,477,435,847	127,662,569	10,296,560	40,765,659	-	3,656,160,636
Blerjet gjatë viti ushtrimor	5,595,095	14,951,799	-	1,408,200	-	21,955,095
Shitjet gjatë viti ushtrimor	-16,475,491					-16,475,491
Nxjerrje jashte perdorimit						-
Plusvlere/minusvlere rivlerësimi						-
Pakësime/Shtesa të tjera						-
Gjendja 31 Dhjetor 2017	3,466,555,452	142,614,369	10,296,560	42,173,859	-	3,661,640,240

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e ndryshimit të Amortizimit të AAM materiale

	Toka, Ndertime	Instalime, makineri e pajisje	Mjete transporti	Te tjera ne shfrytezim (mobileri, pajisje, etj.)	Aktive afatgjata materiale ne proces	Total
Gjendja 31 Dhjetor 2015	235,827,495	109,976,424	7,240,507	22,072,937	-	375,117,362
Amortizimi i periudhes ushtrimore	80,489,586	17,686,102	885,165	3,851,420	-	102,912,274
Amortizim Pakësime/Shtesa të tjera	-	-3,238,238	-	-337,389	-	-3,575,628
Humbje nga Testi i vleres gjate periudhes	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAGJM te shitura	-	-25,105,968	-608,507	-564,513	-	-26,278,989
Amortizimi i AAGJM te Nxjerra jashte perdorimit	-	-17,105,900	-	-	-	-17,105,900
Gjendja 31 Dhjetor 2016	316,317,081	82,212,420	7,517,165	25,022,455	-	431,069,120
Amortizimi i periudhes ushtrimore	157,688,036	9,622,255	555,880	3,395,079	-	171,261,250
Amortizim Pakësime/Shtesa të tjera	-	-	-	-	-	-
Humbje nga Testi i vleres gjate periudhes	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAGJM te shitura	-6,640,476	-	-	-	-	-6,640,476
Amortizimi i AAGJM te Nxjerra jashte perdorimit	-	-	-	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2017	467,364,640	91,834,675	8,073,045	28,417,534	-	595,689,894
Vlera neto me 31 Dhjetor 2016	3,161,118,767	45,450,150	2,779,395	15,743,204	-	3,225,091,516
Vlera neto me 31 Dhjetor 2017	2,999,190,812	50,779,694	2,223,515	13,756,325	0	3,065,950,346

Shtesat e aktiveve në vitin 2017 per ndertesen ka ardhur nga përfundimi i disa shërbimeve ndertimore të ndërtesës objekti Drini. Shtesat e tjera kanë ardhur nga blerjet, te cilat janë njohur me koston e blerjes, ndërsa pakesimet kane ardhur nga amortizimi i plote i disa pajisjeve te inventarit, si dhe amortizimet vjetore.

12. Detyrimet

Detyrimet perbehen nga detyrimet afatshkurtera dhe ato afatgjata. Sipas kontabilitetit te klasifikuara ne kete kriter ato paraqiten:

12.1 Detyrimet afatshkurtera

Paraqitja e tyre ne bilancin kontabel jepet si ne tabelen qe vijon:

Detyrime afatshkurtera	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Furnitorë për blerje e shërbime	343,233,939	735,967,636
Personeli	3,936,224	3,725,453
Detyrime tatimore	4,918,648	5,763,335
Detyrime te tjera	-	24,000
Parapagimet e arkëtuara	21,759,647	21,963,515
Totali	373,848,458	767,443,939

12.1/a) Detyrimet ndaj Furnitoreve

Detyrimet ndaj furnitoreve jane paraqitur ne bilanc per shumat qe do te paguhen pas dates 31.12.2017. Një paraqitje analitike e tyre jepet ne tabelen më poshte:

Pershkrimi	Viti 2017	Viti 2016
Furnitore ne leke	334,141,494	677,022,710
Furnitore ne Euro	9,092,445	58,944,927
Total	343,233,939	735,967,636

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

12.1/b) Te pagueshme ndaj punonjesve

Paraqet detyrimin e shoqerise ndaj punonjesve per pagen e muajin dhjetor e cila eshte paguar ne muajin janar 2018.

12.1/c Detyrimet Tatimore

Detyrimet ndaj shtetit per tatime e taksa paraqiten ne seksionin e detyrimeve afatshkurtëra ne Pasqyrat financiare. Përbërja analitike e këtyre detyrimeve ndaj shtetit paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Shteti Sigurimet Shoqerore e Shendetesore	1,372,728	1,264,528
Shteti Tatim Mbi te Ardhurat Personale	286,234	252,643
Tvsh Per tu Paguar	3,259,686	-
Tatim fitimi	-	4,246,164
Total	4,918,648	5,763,335

Sigurime shoqerore e te ngjashme paraqesin shumen e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe TAP te llogaritura mbi pagat e punonjesve per muajin dhjetor. Keto detyrime jane paguar ne muajin janar 2018.

12.1.d) Detyrimet e tjera dhe Parapagimet e marra

Në këto zëra paraqiten detyrimet ndaj personelit dhe te tjereve si dhe detyrimet per arketimet e marra per sherbimet qe do të kryhen në të ardhmen.

12.2 Detyrimet afatgjata

Përbërja e detyrimeve afatgjata paraqitet si vijon:

Huate afatgjata	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Hua, bono dhe detyrime nga qiraja afatgjate	2,163,364,783	1,792,667,761
Huamarrje te tjera afatgjata	605,452,973	548,848,667
Totali	2,768,817,756	2,341,516,428

12.2/a) Hua, bono dhe detyrime nga qiraja afatgjate

Përbëhen nga hua bankare afatgjata. Një paraqitje e tyre jepet në tablën vijuese:

Pershkrimi	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
FIB	117,824,808	164,576,751
Tirana bank	-	162,276,000
Banka Popullore	-	20,175,030
Alfa Bank	-	803,050,054
BKT	2,045,539,975	372,129,926
Raiffesien bank	-	270,460,000
Total	2,163,364,783	1,792,667,761

Për vitin 2017 shoqëria ka bërë një ristrukturim të kredive të saj sic dhe paraqitet në tablën më lart.

12.2/b) Huamarrje te tjera afatgjata

Ne kete ze perfshihet detyrimi qe shoqeria TID i ka Agna Investitor ne leke.

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

13 Kapitalet e veta

Përbërja e kapitaleve të veta paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Kapitali i paguar	650,734,000	650,734,000
Rezerva ligjore	5,675,371	3,700,731
Fitimi (Humbja) i/e vitit te kaluar	676,211,989	638,693,824
Fitimi (Humbja) i/e vitit financiar	-46,972,433	39,492,805
Total	1,285,648,927	1,332,621,360

Kapitalet e veta te shoqerise jane shtuar nga fitimet e pashpërndara

14. Të ardhurat nga shitjet neto

Gjatë vitit 2017 shoqëria ka realizuar të ardhura nga shitjet e situacioneve, shërbimeve, qirave, shitja shërbime qendra Nobis, etj Përbërja e shitjeve neto paraqitet si në tabelën vijuese:

Pershkrimi	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Te ardhura nga kryerja e shërbimeve, situacione	1,977,735	1,152,167,152
Nga shitja e produkteve te prodhimit vet	130,164,279	137,777,307
Te ardhura nga shitja e mallrave e tjera	14,209,299	15,575,327
Te ardhura nga qirate	235,151,820	167,159,577
Shitje Produkti i gatshem - Ndertesa	130,841,400	-
Total	512,344,533	1,472,679,363

Në grupin e të ardhurave nga kryerja e shërbimeve jane paraqitur situacionet e punimeve te kryera per vitin 2017.

Ne te ardhurat nga shitja e produkteve te prodhimit te vet paraqiten të ardhurat nga qendra Nobis, dhe në të ardhurat nga qiratë përfshihen qiradhëniet e ndërtesave në pronësi të shoqërisë..

15. Të ardhura të tjera

Përbërja e të ardhurave të përfshira në këtë zë ne menyre analitike pasqyrohet si me poshte:

Pershkrimi	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Te ardhurat nga shperndarja e fat të Energjiise, ujit, karburantit	1,024,484	2,083,134
Te ardhura nga shitja e AAM	56,826,325	16,105,307
Vlera kontabel e AAM te shitura	-9,835,014	-15,161,497
Te ardhurat nga autofaturat	450,982	8,498,666
Shpenzimet nga autofaturat	-450,982	-8,498,666
Shitje inventar i imet	-	204,830
Total	48,015,795	3,231,773

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHIKRUHET

16. Materialet e konsumuara

Në këtë zë janë përfshirë kostoja e blerjes së materialeve të para, mallrave dhe materialeve ndihmëse për aktivitetin e ndertimit dhe te tregetise dhe shërbimet ne funksion te aktivitetit kryesor te shoqerise si shpenzime per punimet nga nenkontraktorët, shpenzime per energji elektrike, transport, kosto e ndërtesave të shitura etj. Analitikisht përbërja e këtij paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Lendet e Para	23,597,592	453,111,082
Mallra	13,156,572	12,263,265
Kosto produkte te gatshme - Ndertesa	85,107,613	-
Trajtime te pergjithshme,	18,500	576,562,331
Shpenz. Energji + uje	20,832,166	26,610,504
Transport materialesh	-	2,874,519
Kancelari, Materiale pastrimi etj	2,246,938	6,139,507
Total	144,959,381	1,077,561,208

17. Shpenzime personeli

Gjate vitit shoqeria ka llogaritur, deklaruar dhe paguar ne përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore për punojnësit. Paraqitja si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Shpenzime per paga	58,209,415	58,050,057
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore e shendetstore	9,675,799	9,702,145
Total	67,885,214	67,752,202

18. Zhvleresime dhe amortizime

Ne këtë zë të shpenzimeve perfshihen amortizimet e llogaritura gjatë vitit 2017 te ndertesave, makineri e pajisje, mjete transporti. Per efekt te llogaritjes se tatim fitimit fiskal eshte bere zbritja e shpenzimeve te amortizimit tej normave ndersa shpenzimet per amortizimin e aktiveve te tjera afatgjata jane llogaritur me normat e amortizimit ne mbeshtetje te ligjit per "Tatimin mbi te ardhurat" mbi vleren e mbetur.

19. Shpenzimet te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

Përbërja e këtij zëri analitikisht paraqitet si vijon:

	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Primet e sigurimit	546,539	1,031,682
Shpenzime mirembajtje dhe administrimi	6,434,030	6,618,233
Qira	6,768,468	6,829,963
Pagesa te ndermjetme dhe honorare, anetaresim	3,188,585	9,695,057
Reklama, publicitet	3,410,153	2,133,022
Shpenzime telefoni . vodafon dhe tel. Fiks	915,693	1,095,363
Tatime , taksa bashkie e automjete.taks. m2	9,562,159	10,034,591
Shpenzime udhetimi dhe dieta	563,635	413,877
Shpenzime per sherbime bankare	22,238,925	3,109,468
Sponsorizime e subvencione	312,800	3,401,584
Gjoha dhe penalitete	53,839	693,424
Diferenca kurse kembimi te trete	138,172	-22,580,600
Shpenzime te tjera per personelin	806,158	716,865
Shpenzime për pritje përcjellje	2,029,499	1,770,795
Shpenzime te tjera	2,081,157	3,595,136
Vlera kontabel e AA te nxjerra jashte perdorimit	-	2,512,960
Shpenzime te ndryshme te panjohura	1,047,814	9,521,468
Total	60,097,625	40,592,888

Shpenzimet e tjera paraqiten shpenzime te ndryshme per material te vogla konsumi, dhe sherbime gjate aktivitetit normal te shoqerise.

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT" SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

20. Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

Paraqiten si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
Te Ardhura nga Interesi	211	1,411
Shpenzime nga Interesi	(125,806,368)	(131,859,755)
Total	(125,806,157)	(131,858,344)

Shpenzime per interesa paraqesin shumën e interesave të paguara për huatë e marra nga bankat e ndryshme. Ato janë llogaritur në bazë të pagesave të kryera sipas schedulit të huasë. Fitimi nga interesat paraqet interesat bankare të llogaritura nga bankat për gjendjen e mjeteve monetare pranë tyre. Në këtë zë praqitet shuma neto e shpenzimeve të interesave me të ardhurat nga interesat.

21. Fitimet dhe Humbjet nga kursi i këmbimit

Pershkrimi	31 Dhjetor 17	31 Dhjetor 16
<i>Fitimi nga Kurset e këmbimit</i>		
Fitime nga azhurnimi i Arkes/Bankes	814,636	64,855
<i>Humbje nga Kurset e këmbimit</i>		
Humbje nga azhurnimi i Arkes/Bankes	-4,763,729	-297,144
Total	-3,949,093	-232,289

Humbjet nga kursi i këmbimit paraqesin humbjet e vërtetuara gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditeteve, në monedhë të huaj.

22. Tatimi aktual mbi fitimin

Shoqëria ka rezultuar me një humbje kontabël 43 milion leke leke. Për llogaritjen e rezultatit tatimor të vitit 2017 shoqëria ka bërë rregullimet e nevojshme fiskale, duke konsideruar si të panjohura për qellime fiskale një sërë shpenzimesh.

Shoqëria ka zbatuar kërkesat e ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat" për njohje dhe mosnjohjen e shpenzimeve për efektet e llogaritjes të fitimit të tatueshëm.

Llogaritja e shpenzimeve të panjohura, dhe të ardhura të patatueshme të rezultatit fiskal për vitin 2017 paraqiten si në tabelën vijuese:

Pasqyra e rezultatit tatimor 2017	Viti 2017	Viti 2016
Fitimi/Humbja e vitit	-43,476,090	55,001,932
Korigjimet e rezultatit sipas ligjit tatimor:	66,785,041	48,392,248
Shpenzime të panjohura	36,907,343	48,392,248
<i>Shpenzime të tjera</i>	1,540,279	9,521,468
<i>Shpenzime për Sponsorizime</i>	312,800	3,401,584
<i>Gjoha Penalitete e të ngjashme</i>	53,839	693,424
<i>Amortizim i pjesës së rivlersuar</i>	14,922,594	15,662,824
<i>Shpenzime Interesi të panjohura</i>	20,077,831	19,112,949
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet	29,877,698	-
Totali i shpenzimeve të panjohura	66,785,041	48,392,248
Fitimi/Humbja i tatueshëm para mbartjes së humbjes fiskale	23,308,951	103,394,179
Fitimi/Humbja fiskale e vitit	23,308,951	103,394,179
Norma e tatimit aktual mbi fitimin	15%	15%
Tatimi aktual mbi fitimin	3,496,343	15,509,127
Shpenzimi kontabël i tatimit mbi fitimin	3,496,343	15,509,127

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

22. Tatimi aktual mbi fitimin-vazhdim

Gjate vitit 2017 shoqëria ka njohur pjesën e saj të humbjes në pjesmarren që ka në shoqërinë The Plaza sh.a duke përdorur metodën e kapitalit. Kjo humbje për efekte fiskale sipas ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat" konsiderohet e panjohur dhe për këtë qëllim është bërë dhe rregullimi i rezultatit kontabel për llogaritjen e rezultatit të tatueshëm.

23. Transaksionet me palët e lidhura

Sipas statutit të shoqërisë, organi më i lartë vendimmarrës është asambleja e ortakëve. Shoqëria drejtohet nga administratori i saj. Gjatë vitit 2017 shoqëria ka kryer transaksione me palët e lidhura, këto transaksione janë realizuar me shoqërinë The Plaza sh.a duke qenë se zoteron 45% të aksioneve të kësaj të fundit. Në paraqitje të shumave të transaksioneve të kryera me palët e lidhura gjatë vitit 2017 paraqitet si vijon:

Bilanci Kontabël:

	Viti 2017	Viti 2016
<i>Levizjet gjatë vitit</i>		
1. Llogaritje të Arketueshme	192,770,719	46,405,926
2. Huadhenie Afatshkurtra	-	307,515,175
Gjendja më 01.01.2017	307,515,175	80,140,000
<i>Rritja të huadhenieve</i>	192,240,725	242,306,885
<i>Pakesim nga shlyerja e huadhenieve</i>	-499,755,900	-14,931,710
	192,770,719	353,921,101
<i>Levizjet gjatë të vitit</i>		
1. Llogaritje të Pagueshme për furnizime	3,311,383	2,959,646
Totali	3,311,383	2,959,646

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

	2017	2016
<i>Te ardhura dhe shpenzime</i>		
Te Ardhura nga Shitja produkteve dhe të tjera	111,274,222	39,639,179
Shpenzime Blerje Mallrash	-3,095,809	-2,639,441
Totali	108,178,414	36,999,738

Një paraqitje e gjëndjeve më 31.12.2017 të llogarive me palët e lidhura jepet në vijim:

	31.12.2017	31.12.2016
<i>Tepërcat në Fund të vitit</i>		
1. Llogaritje të Arketueshme	91,637,744	48,903,129
2. Huadhenie afatshkurtra	0	307,515,175
3. Llogaritje të Pagueshme për furnizime	6,212,120	2,959,647
Tepërica	97,849,864	359,377,951

24. Ngjarjet mbas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.